
**OBSERVATIONS ON THE EDITING OF THE WORKS "LINGUISTIC STUDIES" BY
EKREM ÇABEJ**

Luljeta Adili-Çeliku

Faculty of Philology, UKIM, Skopje, R. North Macedonia, Ladili@flf.ukim.edu.mk

Gonxhe Gashi

Faculty of Philology, SEEU, Tetovo, R. North Macedonia, gg30527@seeu.edu.mk

Arta Malota

Faculty of Philology, SEEU, Tetovo, R. North Macedonia, am30476@seeu.edu.mk

Abstract: Spelling is the most important and sensitive issue of the Albanian language. Spelling is considered the crown of the Albanian language, after all the many years of efforts that have been made to have a unified language for Albanians. Spelling is defined as the care to write and speak in accordance with the rules and the best models of the beautiful Albanian language.

Fifty years ago, in 1972, the Albanian Spelling Congress was held in Tirana, with the support of the Institute of Linguistics and Literature, with the presence of 87 delegates from all over Albania, where the Albanian language reached the standards of a modern language and unified in the culture of correct writing. This congress marks the end of a long and arduous stage, through which the Albanian people have gone, with continuous efforts, to first write and document the Albanian language, then normalize and standardize it, as it is today.

At the Spelling Congress, one of the most prominent delegates was Eqrem Çabej, who is considered the most important and contributing man of Albanian linguistics. His multidimensional studies on the Albanian language, well-argued and very objective, which affect both its historical and prehistoric side, as well as the phonetic and grammatical side, are the main help even today for the science of Albanian linguistics, and that, his contribution to this field is indisputable, as much as it is necessary for every linguist who wants to study the Albanian language.

The purpose of the study is to highlight the wrong forms in Çabej's volumes "*Linguistic studies*", which will resemble a confrontation of Çabej with himself (until it is proven in this paper, in some way, the reason why this linguistic lack of culture in his volumes is likely to happen), since he was one of the founders of setting spelling norms in the 1972 congress, as well as the main purpose of this paper is to have an impact on Albanian language researchers; to reprint the works "*Linguistic studies*" in a higher quality printing house, with good spelling experts (lecturers and editors), so that these volumes with a great weight in terms of language can be reproduced in a better quality, but also so that there are enough of such books, because they are found with great difficulty in our libraries and bookstores. Therefore, it has to always be emphasized that, without the works "*Linguistic studies*", no real and fundamental study in the linguistic aspect can be started. The analyzes and reviews in this paper are handled through the theoretical analysis method, as well as the comparative method.

Keywords: misspellings, spelling, language studies, editing, publishing.

**VËSHTRIME RRETH REDAKTIMIT TË VEPRAVE "STUDIME GJUHËSORE" TË
EQREM ÇABEJT**

Luljeta Adili-Çeliku

Fakulteti Filologjik, USHKM, Shkup, Ladili@flf.ukim.edu.mk

Gonxhe Gashi

Fakulteti Filologjik, SEEU, Tetovë, gg30527@seeu.edu.mk

Arta Malota

Fakulteti Filologjik, SEEU, Tetovë, am30476@seeu.edu.mk

Abstrakt: Drejtshkrimi është çështja më e rëndësishme dhe më e ndjeshme e gjuhës shqipe. Drejtshkrimi konsiderohet kurora e gjuhës shqipe, pas të gjitha përpjekjeve shumëvjeçare që qenë bërë për të pasur një gjuhë të unifikuar për shqiptarët. Drejtshkrimi përkufizohet si kujdesi për të shkruar e për të folur në përputhje me rregullat e modelet më të mira të gjuhës së bukur shqipe.

Pesëdhjetë vjet më parë, më 1972, në Tiranë është mbajtur Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, me mbështetjen e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, me praninë e 87 delegatëve mbarëshqiptarë, ku gjuha shqipe arrin t'i ketë standardet e një gjuhe moderne dhe të unifikuar në kulturën e të shkruarit drejt. Ky kongres shënon

përmbylljen e një etape të gjatë e të mundimshme, nëpër të cilën ka kaluar populli shqiptar, me përpjekjet e vazhdueshme që gjuhën shqipe, fillimisht, ta shkruajë e ta dokumentojë, pastaj ta normëzojë e ta standardizojë, kështu siç është edhe sot.

Në Kongresin e Drejtshkrimit, njëri nga delegatët më të spikatur ishte edhe Eqrem Çabej, i cili konsiderohet njeriu më i rëndësishëm dhe më kontributdhënës i gjuhësisë shqiptare. Studimet e tij shumëdimensionale për gjuhën shqipe, të argumentuara mirë dhe tejet objektive, që prekin si anën historike e parahistorike të saj, ashtu edhe anën fonetike e gramatikore, janë ndihmesë kryesore edhe sot për shkencën e gjuhësisë shqiptare, dhe që, kontributi i tij në këtë fushë është i pakontestueshëm, po aq sa edhe i nevojshëm për secilin gjuhëtar që rreket të studiojë gjuhën shqipe.

Si qëllim i studimit është nxjerrja në pah e trajtave të gabuara në vëllimet e Çabejt “*Studime gjuhësore*”, që do të ngjajë si një ballafaqim i Çabejt me vetveten (derisa të vërtetohet në këtë punim, në njëfarë mënyre, shkaku se pse ka ngjarë kjo moskulturë gjuhësore në vëllimet e tija), duke qenë se ai ishte njëri nga themeluesit e vënies së normave drejtshkrimore në kongresin e vitit 1972, si dhe, qëllimi kryesor i këtij punimi është që të ketë ndikim te studiuesit e gjuhës shqipe; të ribotohen veprat “*Studime gjuhësore*” në ndonjë shtypshkronjë më cilësore, me njohës të mirë të drejtshkrimit (lektorë e redaktorë), në mënyrë që të risillen më me cilësi këto vëllime me peshë të madhe në aspektin gjuhësor, por edhe që të ketë mjaftueshëm libra të tillë, sepse gjenden me mjaft vështirësi në bibliotekat e në libraritë tona. Andaj, do theksuar gjithmonë se, pa veprat “*Studime gjuhësore*”, nuk mund të nisë asnjë studim i mirëfilltë e rrënjësor në aspektin gjuhësor.

Analizat dhe shqyrtimet në këtë punim janë trajtuar përmes metodës së analizës teorike, si dhe, metodës krahasimtare.

Fjalët kyçe: gabime drejtshkrimore, drejtshkrim, studime gjuhësore, redaktim, botim.

1. VËSHTRIME MBI REDAKTIMET GJUHËSORE TË VEPRAVE ”STUDIME GJUHËSORE” TË ÇABEJT

Duke ditur që Çabej është marrë rrënjësisht me gjuhën shqipe, i ka trajtuar të gjitha fjalët nga të gjitha kënvështrimet gjuhësore, në këtë punim janë bërë përjasje ndërmjet veprave “*Studime gjuhësore*” dhe parimeve të kulturës gjuhësore, janë veçuar (janë marrë) shembujt e shkruar në forma të pasakta në këto vepra dhe janë dhënë trajtat e sakta, të cilat i parasheh drejtshkrimi i shqipes. Por, a duhet konsideruar të jenë lëshime të shkrimeve të Çabejt, kur 9 veprat e tija janë botuar me mbikëqyrjen e disa redaktorëve të njohur shqiptarë?

Vëllimet “*Studime gjuhësore*” janë botuar në vitet: 1976, 1986, 1987 dhe 1988, ndërsa Kongresi i Drejtshkrimit që mbajtur 4 vjet më parë. A janë bërë ndërhyrje në gjuhën standarde pas atij kongresi? Si ka mundësi të mos jenë përfillur normat drejtshkrimore plotësisht në këto botime? Cilët duhet të kenë qenë faktorët që kanë ndikuar në mospërputhjen e fjalëve me ligjet e nxjerra të gjuhës shqipe? Pse nuk u ribotuan më këto vepra?

Në vëllimet “*Studime gjuhësore*”, në njërën anë mund të mendohet se nuk mund të kenë ndikuar redaktorët në shkeljen e normave drejtshkrimore, sepse nuk vërehen ndryshime të njërës libër nga tjetri, ngaqë, stili i Çabejt në të shkruar, lehtësisht identifikohet dhe përkapet nga lexuesi, dhe që jo të njëjtit redaktorë ndodhen në të gjitha veprat, por, në një anë tjetër, edhe pse nuk mund të argumentohen me saktësi këto dyshime, mund të mendohet se veprat “*Studime gjuhësore*”, fillimisht, mund të kenë qenë dorëshkrime të Çabejt më të hershme se Kongresi i Drejtshkrimit, dhe që, edhe redaktorët e këtyre veprave, mbase mund të kenë filluar në kohë më të hershme të merren me anën lektoriale dhe redaktuese, meqë, logjikisht, është dashur kohë e gjatë për t’u shqyrtuar e për t’u rishikuar imtësisht brendagjuhësore të studimeve të Çabejt, sepse, në kumtesën e Çabejt parashtuar Kongresit të Drejtshkrimit, pikërisht në paragrafin e fundit, kërkohet nga hartuesit e drejtshkrimit (duke përfshirë edhe veten), që të punojnë me përgjegjësi e me kujdes të madh rreth çështjes së drejtshkrimit, sepse kjo gjë do të vlejë për miliona shqiptarë. Dhe kjo, ka qenë një kërkesë e drejtë nga një gjuhëtar i madh, por, duke qëndruar në një linjë me stilin e tij në nëntë vëllimet “*Studime gjuhësore*”, mbase duhet ta ketë lënë (jodrejtëpërdrejt) një shteg të hapur për një kongres të dytë drejtshkrimor, ku do të përfshiheshin edhe shumë fjalë e aspekte të tjera të mbetura jashtë kongresit. Megjithatë, gjuha shqipe, në aspektin drejtshkrimor, nuk ka ndryshuar pas kongresit të vitit 1972; përkritazi me vendimet e atij kongresi është hartuar leksikografia shqipe (janë botuar disa fjalorë të gjuhës shqipe), duke mos pasur nevojë për ndryshime të tjera, përveç aspektit sinonimik, në qoftë nevoja.

2. “STUDIME GJUHËSORE”

Redaktorët e 9 vëllimeve “*Studime gjuhësore*”, nuk janë të njëjtit në secilën vepër. Në veprat: I dhe II, redaktorë janë: Ahmet Kelmendi, Sulejman Drini dhe Mehmet Gjevari. Në veprat: III, IV, V, VI dhe VIII, redaktor është Fahredin Gunga. Në veprat VII dhe IX, redaktor është Nazmi Rrahmani, e megjithatë, disa fjalë dalin të përsëritura në të gjitha vëllimet, si fjalët e ndryshueshme: *ndroj* ose *ndruan*, që duhen shkruar *ndërroj* dhe *ndërruan*; *marr* në të kryerën e thjeshtë e shkruar vazhdimisht *muar* dhe *muarën*, që duhet *mori* dhe *morën*; folja e shkruar gjithmonë

spiegogj dhe si emër *spiegim*, që duheshin shkruar *shpjegogj* dhe *shpjegim* etj., mirëpo, çka vlen për t'u theksuar se, në veprën VII, gabimet drejtshkrimore janë më të padukshme, më të pakta, me redaktim të Nazmi Rrahmanit, gjë që bën të kuptohet se mospërfillja e rregullave të drejtshkrimit në 9 vëllimet e Çabejt është çështje e punëtorëve të redaksisë së atëhershme “*Rilindja*”, me gjithë rëndësinë që ka pasur në çdo kohë për nevojat e shtypit të librit, gazeta “*RILINDJA*”, e cila është themeluar në vitin 1945 në Prizren (para Kongresit të Drejtshkrimit), dhe mbetet gazeta dhe shtypshkronja e parë në Kosovë me cilësi të larta, si përfaqësuese e shqiptarëve në kohën e atëhershme të Jugosllavisë. Dhe duke qenë kaq e hershme si gazetë dhe si shtypshkronjë, me gjithë ndryshimet dhe evoluimet që mund të ndodhin në gjuhë dhe në rregullat e saj, është e natyrshme që mund të jenë bërë edhe gabime drejtshkrimore, sikurse porositi edhe Kongresi i Drejtshkrimit: “*Duke marrë parasysh ndryshimet që pëson gjuha letrare gjatë zhvillimit të saj, si dhe, çështjet që nxjerr praktika gjuhësore, “Rregullave të drejtshkrimit” t’u bëhen përmirësimet dhe plotësimet e duhura në të ardhmen, nëse është nevoja*” (Prishtinës, 1974, f. 17).

Mospërfillja e normave të drejtshkrimit në nëntë vëllimet e Çabejt, vihet në pah dukshëm në sistemin emëror të shqipes, për shembull: në kategorinë e shumësit të emrave, në rasat e zhdrejta, përdoret një mbaresë *-t* fundore në emrat femërorë shumës: *largimi i dy dialekteve kryesore* (Çabej, 1988, f. 15); *e kolonivet* (Po aty: f. 39), *e gjuhëvet, e dukurivet, e formavet, emravet, të rasavet, e mbaresavet, e spirantevet, të arbëreshëvet, i malësorëvet, i zanorëvet, vrojtëvet, e së cilavet* etj. Këto forma fjalësh, janë forma të vjetra të pranishme në disa nëndialekte ose të folme, por jo në gjuhën standarde. “*Për trajtën e rrjedhës, duhet përmendur se në të folmet e anës veriperëndimore të Shqipërisë, emrat femërorë të shquar, kanë një formë që ka dalë nga bashkimi i formës së rrjedhës së pashquar me nyjën t(ë)*” (Shkurtaç, 2016, f. 77).

Emrat e albanologëve, rrallëherë i shohim të shkruar shqip dhe të shquar në pajtim me morfologjinë dhe fonetikën shqipe, si: *Leibniz, Hahn, Weigand* etj., që duhet: *Lajbnici, Hani, Vajgandi* etj., ose, edhe në rastet kur janë përdorur me mjete gramatikore të shquarësisë, nuk është respektuar fonetika e gjuhës shqipe, por emrat e studiuesve e të albanologëve të huaj janë shkruar me veshje tingullore të alfabeve të huaja (emrat ose mbiemrat origjinalë të studiuesve), e që parimisht duheshin shkruar shkronjë për shkronjë në pajtueshmëri me fonetikën shqipe, si: *Meyeri, Lambertzi, Hahn, Weidand, Thunmann, Miklosich* etj. (Çabej, STUDIME GJUHËSORE I, 1976, f. 46), që duhen shkruar: *Majeri, Lamberci, Hani, Vajgandi, Tumani, Mikloshiqi* etj., ose edhe *i/e/të/së Bopp*, që duhet *i/e/të/së Bopit*; sikurse *Bopp*, që duhet *sikurse Bopi* etj., që duhen respektuar fonetika dhe morfologjia e gjuhës shqipe. “*Tek emrat dhe mbiemrat e huaj duhet përdoren mbaresat dhe nyjat e përparme të shqipes*” (Prishtinës, 1974, f. 80).

Mbaresat rasore të disa emrave mashkullorë janë përdorur me formantë të emrave femërorë: *shumëset e dikurshme, femërorët e sotme* (Çabej, STUDIME GJUHËSORE III, 1987, fv. 380, 381) etj., që duhet të shkruhen: *shumësat e dikurshëm*, apo më mirë, *kategoria e shumësit kohë më parë* etj., siç mund të argumentohet: “*shumës-,i m. sh. -a(t) kategoria gramatikore e numrit shumës; shumësi i shquar (i pashquar)* (Shqipërisë, 2006, f. 1067); *te femërorët dhe mashkulloret*, që duhen shkruar: *emrat femërorë dhe mashkullorë* (femërorët dhe mashkullorët), e shumë emra të tjerë të këtij lloji. Pastaj, janë shkruar vazhdimisht me shkronjë të madhe fjalët e sistemit emëror: *Shqiptarët, Arbëreshët, Osmanët, Gjermanët, Rumunët* etj., që duheshin shkruar me shkronja të vogla, si emra (mbiemra) të përgjithshëm.

Pjesorja e disa foljeve nuk përkon me drejtshkrimin, p. sh.: folja *vë* e përdorur me formantë të paskajores *për të vuar*, duhet shkruar *për të vënë* etj. Në sistemin foljor, gabimet janë më të shumta, duke përfshirë aspekte fonetike e fonologjike, kuptimet gramatikore etj., p. sh.: *muarën*, është çështje fonetike, sepse është folje apofonike e së kryerës së thjeshtë *morën* (trajta përfaqësuese e së tashmes së dëftores *marr*); *ndron*, folje e së tashmes që në këtë rast krijon opozicion fonologjik me *ndërron* (*ndërroj*); pastaj edhe foljet: *gjinden* (*duhet gjenden*), *ndërmirren* (*duhet ndërmerren*), *pëshiteten* (*duhet mbështeten*), është reduktuar grupi *mb* në *p*); *studjoj* që duhet *studioj*, *spiegogj* (*duhet shpjegogj*), folje e zgjedhimit të parë me trajtë përfaqësuese të kohës së tashme të dëftores *shpjegogj*), *për të spieguar* me elemente gramatikore të paskajores dhe të së ardhmes, varet kontekstualisht, që duhet *për të shpjeguar* etj.

Janë përdorur fjalë të tipit *hapësiror-e* të cilat nuk kanë kaluar në rotacizëm, dhe mbeten me trajta të gegërishtes, pra, duheshin shkruar *hapësinor-e* etj.

Një çështje tjetër që do diskutim, është dukuria fonetike e elizionit, që është e pranishme shpeshherë në të gjitha veprat, e që drejtshkrimi nuk e parasheh në mënyrën si është përdorur në veprat e Çabejt: *është e lidhur ngushtë, është i mendimit* etj., si dhe te emrat e përveçëm: *t’Azisë, t’Italisë* (Çabej, STUDIME GJUHËSORE V, 1988, fv. 34, 136) etj. Elizioni lejohet vetëm në përdorimin e trajtave të shkurtra të bashkuara, te përemri pyetës *ç’*, te pjesëzat mohuese dhe te pjesëzat që shërbejnë si formantë vetvetorë pësorë për kohën e kryer të thjeshtë. “*Elizioni është më tepër i shprehur në gjuhën e folur, sidomos në ligjërimin e shpejtë*” (Dodi, 2004, f. 152).

Gabime të dukshme vërehen edhe në aspektin sintaksor. Ndodh të mos jetë përshtatur në gjini përcaktori me gjymtyrën kryesore: *emrat e huaja*, që duhet *emrat e huaj*; *këto tre brezat e fundit*, duhet *këta breza*; *kur flasim për këtë libër, si më të vjetrën të shqipes*, që duhet *më të vjetrin*; *përemra të pacaktuara*, që duhet *përemra të pacaktuar*

për t'u përshtatur gjymtyra e dytë me gjymtyrën kryesore të fjalisë etj. Pastaj janë shkruar shumësat si të gjinisë femërore: *femëroret e sotme*, *femëroret e singularizuara* etj., që duheshin shkruar në mënyrë harmonike në kuadër të kategorisë së gjinisë mashkullore: *femërorët e sotëm*; *femërorët e singularizuar* etj.

Duhet përfshirë edhe përdorimi jo i saktë i trajtave të shkurtra, të cilat kryejnë funksione sintaksore, dhe që, në kontekste fjalish, në raste të organizimit të fjalisë, trajtat e shkurtra japin shumë për të kuptuar se me çfarë fjalë janë duke u shoqëruar, e në veprat “*Studime gjuhësore*” dalin të paharmonishme me fjalët shoqëruese, si: *ja* për *ia*; *i u* e shkruar ndaraz, në vend se *iu*: “*Pal Skiroi i u vu punës*” (Çabej, *STUDIME GJUHËSORE VI*, 1988, f. 17); *duke i çelur rrugën kërkimeve* (duhet, duke *ua* çelur rrugën kërkimeve; *atyre, kërkimeve, atyre ua*); *t'ja* në vend të *t'ia*; *i* në vend të *ia*: *për t'i ulur vlerën kësaj vepe*, duhet *për t'ia ulur vlerën* etj.

Shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme është mjaft i pranishëm në disa fjalë, si: *shtektim-e (t)* (duhet të shkruhet me bashkëtingëlloren kundërvënëse të *k-së*, në aspekt zëshmërie, me grykoren *g*); *prak, i/e praktik* (duhet me bashkëtingëlloren e zëshme grykore *g-prag-u*); *bronc-i*, është shkruar me *c* fundore të shurdhër, që për nga zëshmëria i kundërvihet bashkëtingëllorja e zëshme *x*, mirëpo, në këtë rast, *c-ja* ka zëvendësuar *z-në* në fjalën e gjuhës standarde *bronz*, e cila (z-ja) krijon opozicion fonologjik të zëshmërisë me *s-në*; *funkcion-i/e funksioneve*, që duhet *funksion-i/e funksioneve* etj.

“*Standardi, jo vetëm që nuk ruhet, por edhe dëmtohet keq*” (Murati&Dulaj: 2021).

3. REKOMANDIME

Duke qenë se veprat “*Studime gjuhësore*” janë pasuri e madhe për gjuhën shqipe, rekomandohet që këto vepra të mos mbeten nën hije për gjeneratat e ardhshme (sepse janë të pakta në numër dhe mezi gjenden), por të merren parasysh nga gjuhëtarët dhe nga përfaqësuesit e shtëpive botuese, që të ribotohen, të korrigjohen e të vihen sa më shumë në sipërfaqe, ngaqë janë të domosdoshme për çdo fushë të studimit të gjuhës shqipe.

Andaj, ribotimet të mos i lejohen çfarëdolloj shtëpie botuese, por të zgjidhet një shtëpi botuese më cilësore, dhe në këtë mënyrë, të merren dhe të zgjidhen lektorë dhe redaktorë që janë gjuhëtarë të kualifikuar e njohës të mirë të kulturës gjuhësore, pasi veprat “*Studime gjuhësore*” nuk janë vepra dosido, por këto vepra me gjurmime rrënjësore të shqipes janë monumente historike dhe lëvizëse që shërbejnë në çdo kohë, si shtyllat kryesore, mbi të cilat është ngritur e është zhvilluar gjuha shqipe.

BIBLIOGRAFIA

Akademia. (2020). *Revistë për letërsi, kulturë, gjuhë, media*: Prishtinë.

Akademia e Shqipërisë, (2006). *Fjalor i Gjuhës Shqipe*. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Çabej, Eqrem. (1976). *STUDIME GJUHËSORE I*. Prishtinë: Rilindja.

Çabej, Eqrem. (1987). *STUDIME GJUHËSORE III*. Prishtinë: Rilindja.

Çabej, Eqrem. (1988). *STUDIME GJUHËSORE*. Prishtinë: Rilindja.

Çabej, Eqrem. (1988). *STUDIME GJUHËSORE V*. Prishtinë: Rilindja.

Çabej, Eqrem. (1988). *STUDIME GJUHËSORE VI*. Prishtinë: Rilindja.

Dodi, Anastas. (2004). *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Kulla e shqipes.(2023). <https://gjuhashqipe.com/apps/fmgjsh3>

Murati, Qemal. (2019). *Kulturë gjuhe e komunikimi dhe gramatikë drejtshkrimore*. Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve.

Murati, Qemal & Dulaj, Fridrik (2021). *Kulturë e gjuhës dhe kulturë e të shprehurit*. Gjakovë: Universiteti "Fehmi Agani"

Prishtinës, Instituti. Albanologjik. (1974). *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.

Shkurtaj, Gjovalin. (2016). *Dialektet e shqipes*. Tiranë: Albanian University Press.

Shkurtaj, Gjovalin. (2019). *Si të shkruajmë shqip*. Tiranë: ENEAS